



POLITIKA E PRIVATËSISË DHE KUSHTET E PËRDORIMIT TË FAQES SË INTERNETIT TË MPAY

HYRJE

I nderuar vizitor,

Ju falenderojmë që po vizitoni faqen tonë të internetit. Privatësia juaj është shumë e rëndësishme për ne. Ky dokument përbën Politikën e Privatësisë dhe Kushtet e Përdorimit të faqes së internetit të MPAY (“**Faqja**”) (këtu e më tutje “**Politika**”). Përmes hyrjes në këtë faqe interneti, ju konfirmoni se keni lexuar, bini dakord me dhe pranoni parashikimet e kësaj Politike. Qëllimi i kësaj Politike është njohja nga ana e vizitorëve të Faqes të kushteve të përdorimit të kësaj Faqeje dhe Politikës së Privatësisë, dhe e masave të marra nga MPAY për të dhënat personale. Për hir të qartësisë, MPAY nuk mbledh apo kërkon të dhëna personale përmes Faqes së saj. Përpunimi i të dhënave personale përmes Faqes ndodh vetëm kur vizitorët dërgojnë të dhëna të tilla me vullnetin e tyre të lirë të MPAY (psh. një aplikim për punësim apo një kërkesë/ankesë). Kjo Faqe rregullohet nga ligji shqiptar. Kjo Politikë mund të ndryshojë dhe përditësohet në të ardhmen, megjithatë në asnjë rast nuk do të kufizohen të drejtat e garantuara nga ligji nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Është përgjegjësia juaj të lexoni dhe të jeni në dijeni të versionit në fuqi të Politikës.

Kjo Faqe është faqja zyrtare e shoqërisë MPAY sh.p.k. (këtu e më tutje “**MPAY**”/“**Shoqëria**”). Kjo Faqe ofron informacion mbi produktet dhe shërbimet e ofruara nga MPAY, që ofrohen sipas kushteve përkatëse të përdorimit.

MPAY është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NUIS L01711027V, themeluar dhe regjistruar më datë 11.05.2010, dhe që ushtron aktivitetet në fushën e pagesave dhe transfertave të parave sipas liçensës nr.22 datë 31.05.2011 lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1.1 Qëllimi i kësaj Politike është përcaktimi dhe sqarimi i politikës së privatësisë së ndjekur nga MPAY lidhur me përdorimin e Faqes së saj dhe me të dhënat personale.

1.2 Përmbajtja e kësaj Faqeje është destinuar vetëm për informacion. Hyrja në këtë Faqe është pa pagesë. Një lidhje me një faqe tjetër nuk tregon miratim të asaj faqeje apo të përmbajtjes së saj. Ju jeni përgjegjës për informacionet, opinionet dhe/ose rekomandimet e ofruara nga këto faqe të palëve të treta, si dhe për informimin mbi kushtet e privatësisë së këtyre faqeve.

1.3 Vizitorët e kësaj Faqeje mbeten anonimë. MPAY nuk merr apo mbledh të dhëna personale përmes Faqes së saj, pra ne nuk mbledhim informacion për identifikimin personal të individit tuaj, përveç se në rastin kur ju e dërgoni atë me vullnetin tuaj. Ne mbledhim vetëm informacion të përgjithshëm për vizitorët, si për shembull: sa vizitorë kanë vizituar Faqen tonë, apo cilat rubrika të saj janë klikuar më tepër. Ju mund të dërgoni të dhënat tuaja specifike nëse dërgoni email në adresën e postës elektronike të vënë në dispozicion nga MPAY. Ky informacion do të përdoret vetëm në përputhje me qëllimin për të cilin ai është dërguar (ankesë apo kërkesë për informacion,

aplikim pune, etj.). Duke kontaktuar MPAY, vizitorët do të konsiderohen që kanë pëlqimin e tyre të shprehur dhe të qartë për përpunimin e të dhënave të tyre personale.

1.4 Në kuadrin e ofrimit të shërbimeve të saj, MPAY mund të përpunojë të dhëna personale. Përpunimi i tyre bëhet me pëlqimin e subjektit të të dhënave. Të dhënat personale përpunohen në përputhje të plotë me parashikimet e Ligjit dhe me legjislacionin përkatës në fushën e të dhënave personale. Këta veprime kryhen sipas parimit të respektimit dhe të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të së drejtës së ruajtjes së jetës private.

1.5 Të dhënat personale janë një çështje e një rëndësie të lartë për MPAY, dhe MPAY ka marrë të gjitha masat teknike dhe organizative për mbrojtjen e tyre dhe për zbatimin e të gjitha detyrimeve që burojnë nga kuadri ligjor në fuqi për të dhënat personale. Përpunimi i të dhënave bëhet në përputhje me Kushtetutën, Ligjin, si dhe me një nga vlerat e MPAY që është garantimi i mbrojtjes së të dhënave personale, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

2. PËRKUFIZIME

2.1 **“Komisioneri”** - Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2.2 **“Ligji”** - ligji nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

2.3 **“Pëlqim i subjekteve të të dhënave”** - çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij.

2.4 **“Përpunim i të dhënave personale”** - çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.

2.5 **“Subjekt i të dhënave personale”** - çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale, sipas kuptimit që i jep Ligji.

2.6 **“Të dhëna personale”** - çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

2.7 **“Të dhëna sensitive”** - çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

Përsa i përket termave të përdorur në këtë Politikë që nuk janë papërfshirë më sipër, do të zbatohen përkufizimet dhe parashikimet e Ligjit.

3. WEBSITE I MPAY

3.1 Përsa i përket Faqes, të vetmet të dhëna që shkëmbehen përmes website të MPAY janë email/et dhe/ose emrat e subjekteve që zgjedhin të kontaktojnë MPAY me dëshirë, pra vullnetarisht. Të gjithë email-et fakultative dhe të dërguara në adresën/at e specifikuara në website-n e MPAY nënkuptojnë marrjen e adresës/emailit të dërguesit që nevojitet për të kthyer përgjigje si dhe marrjen e çdo të dhëne tjetër personale që përmban emaili, të dhënë vullnetarisht nga subjekti, nëse

përmban të tilla. Lidhur me vizitorët e Faqes, MPAY mbledh vetëm informacione standarde që kanë të bëjnë me klikimin e rubrikave në këtë Faqe. Ky Informacion mblidhet për qëllime statistikore dhe studimi (për të treguar qasjen e vizitorëve, për të parë se cilat rubrika janë më interesante për vizitorët). MPAY nuk bën asnjë përpjekje dhe nuk mbledh asnjë informacion për identifikimin e vizitorëve. MPAY nuk përdor (dhe nuk lejon ndonjë palë të tretë) mjete statistikore analitike për të ndjekur ose për të mbledhur informacione personale që i bëjnë të identifikueshëm vizitorët e Faqes tonë. Ne nuk lidhim asnjë të dhënë të grumbulluar nga Faqja me ndonjë të dhënë personale që e bën vizitorin të identifikueshëm nga çdo burim që të vijë, si pjesë e përdorimit.

3.2 Përmes Faqes së saj, MPAY nuk mbledh apo ruan cookies. Pra, cookies nuk përdoren për transmetimin apo marrjen e të dhënave personale, dhe asnjë cookie e çfarëdo lloji nuk përdoret për të ndjekur vizitorët e Faqes.

3.3 Duke kontaktuar MPAY, vizitorët dhe/ose kandidatët për punësim do të konsiderohet se kanë dhënë pëlqimin e tyre të qartë dhe të shprehur për përpunimin e të dhënave personale që ata zgjedhin t'i dërgojnë MPAY. Vërtetësia dhe saktësia e këtyre të dhënave është përgjegjësi e Vizitorit dhe/ose kandidatit për punësim.

4. PARIMET E PËRGJITHSHME TË PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

4.1 Përpunimi i të dhënave personale bazohet në kriteret e përcaktuara në Nenin 6 të Ligjit: Të dhënat personale përpunohen vetëm:

- nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;
- për hartimin dhe përmbushjen e kontratave, në të cilat subjekti i të dhënave personale është palë;
- për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave;
- për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;
- për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- për ndjekjen e interesave legjitimë të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat, përveç kur këta interesa mbizotërojnë mbi interesat për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të subjektit të të dhënave.

4.2 Gjatë përdorimit/vizitës së kësaj Faqeje nga kushdo vizitor, nuk merren të dhëna personale të tyre, përveç rastit nëse vizitori zgjedh të kontaktojë MPAY përmes postës elektronike duke ofruar vullnetarisht të dhëna personale (psh. e-mail, apo emër). Të dhënat personale (nëse ka të tilla) të vizitorëve të Faqes përdoren vetëm për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesës së tyre.

4.3 Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave personale bazohet:

- a) në përpunimin në mënyrë të ndershme, drejtë dhe të ligjshme;
- b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- c) në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- d) në saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe, kur është e nevojshme, ato duhet të përditësohen. Në këtë kontekst duhet ndërmarrë çdo hap i arsyeshëm për të fshirë apo

korrigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur apo për të cilin përpunohen më tej;

- e) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

4.4 Mbrojtja e të dhënave personale garantohet me përpunimin e tyre në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshëm nga MPAY për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale apo ligjore në fuqi, si dhe për rritjen e cilësisë së shërbimeve.

5. TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

5.1 Subjektet e të dhënave personale kanë të gjitha të drejtat e njohura nga Ligji.

5.2 E drejta për akses dhe informacion

Në çdo moment, subjekti i të dhënave personale ka të drejtën që nëpërmjet një kërkesë, të aksesojë të dhënat e tij personale si dhe të kërkojë korrigjimin e tyre. Çdo person ka të drejtë pa pagesë që, me kërkesë me shkrim, të marrë:

- a) konfirmimin nëse të dhënat personale po i përpunohen ose jo, informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe për marrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale;
- b) në një formë të kuptueshme, të dhënat personale dhe informacionin e disponueshëm për burimin e tyre;
- c) në rastet e vendimeve automatike, informacion për logjikën e përfshirë në vendimmarrje;
- d) të marrë një kopje të të dhënave të tij;
- e) të dijë burimin e të dhënave, nëse nuk vjen në kundërshtim me interesin publik. Informacioni për të dhënat komunikohet në formën, në të cilën ishin në kohën kur është bërë kërkesa.

Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit dhe të drejtën e tij/saj për t'u ankuar te Komisioneri në lidhje me refuzimin ose për të paraqitur kërkesën për të kontrolluar përjashtimin në rastin konkret. Përgjigja në çdo rast dërgohet në adresën e kërkuar nga vetë kërkuesi.

5.3 E drejta për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen

Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave pa pagesë, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me Ligjin. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit apo të fshirjes. Kur Kontrolluesi nuk bën bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te Komisioneri.

5.4 Vendimmarrja automatike

Çdo person ka të drejtë të mos jetë subjekt i vendimeve, të cilat shkaktojnë efekte ligjore për të ose ndikojnë në mënyrë të rëndësishme tek ai dhe kur vendimi është bazuar vetëm në përpunimin automatik të të dhënave, që synojnë të vlerësojnë disa aspekte personale, që lidhen me të,

veçanërisht, efektivitetin në punë, besueshmërinë ose sjelljen. Një person mund të jetë subjekt i një vendimi të marrë, sipas paragrafit më sipër, kur vendimi:

- është marrë gjatë lidhjes ose zbatimit të një kontrate, nëse kërkesa e paraqitur nga subjekti i të dhënave për lidhjen ose zbatimin e kontratës është përmbushur, ose nëse ka masa të përshtatshme për të mbrojtur interesat e tij të ligjshëm, të tillë si mundësi që e lejojnë atë të parashtojë pikëpamjet e tij;
- autorizohet nga një ligj, i cili, gjithashtu, parashikon masa për të mbrojtur interesat e ligjshëm të subjektit të të dhënave.

5.5 E drejta e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar

Subjekti i të dhënave ka të drejtë pa pagese të kundërshtojë në çdo kohë përpunimin e të dhënave rreth tij, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj. Ai ka të drejtë t'i kërkojë Kontrolluesit të mos fillojë ose, nëse përpunimi ka filluar, të ndalojë përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të, për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë si dhe të informohet përpara përhapjes për herë të parë të të dhënave personale për këtë qëllim.

5.6 E drejta për t'u ankuar

Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë Komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, Kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

5.7 E drejta për kompensimin e dëmit

Çdo person, të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë të kërkojë kompensim, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Civil.

5.8 Çfarëdo lloj kërkesë e subjektit lidhur me të dhënat personale apo nëse mendoni se privatësia juaj është shkelur duhet të adresohet në info@mpay.al ose të dërgohet pranë MPAY: Njësia Administrative nr.5, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla 1, Tiranë, Shqipëri. Në rast mosdhënie informacioni, Shoqëria do t'i shpjegojë subjektit arsyet e mosdhënies së informacionit. Në çdo rast, subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të ankohet te Komisioneri.

6. KËRKESAT PËR INFORMACION DHE ANKESAT

6.1 Kërkesa për informacion mbi produktet dhe shërbimet e Shoqërisë përpunohet nga Departamenti i Produkteve dhe Shërbimeve. Nëse dikush dërgon ankesa të email-i i MPAY, me zgjidhjen e tyre do të merret Departamenti i Produkteve dhe Shërbimeve. Dërgimi i CV-ve për aplikim për punësim nga MPAY përpunohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore. Kur persona aplikojnë për t'u punësuar pranë MPAY, ne përdorim informacionin për procesin e aplikimit të tyre.

Të dhënat personale në lidhje me aplikantët e pasuksesshëm mbahen për 6 muaj pasi konkursi i rekrutimit ka përfunduar, e më pas shkatërrohen ose fshihen. Për të dhënat personale të aplikantëve zbatohen të njëjtat masa mbrojtjeje të parashikuara nga kjo Politikë dhe procedurat e brendshme të MPAY.

6.2 Nëse ju mendoni se privatësia juaj është shkelur ju mund të na kontaktoni në çdo kohë. Stafin ynë do të jetë i gatshëm t'ju ofrojë ndihmën e kërkuar.

6.3 MPAY do t'i përgjigjet çdo kërkesë apo ankese brenda 30 ditësh nga data e marrjes së saj. Përgjigjja do të jetë me shkrim në adresën prej së cilës ka ardhur kërkesa apo ankesa. MPAY do të mbajë dhe ruajë një dosje të ankesave, kërkesave apo sugjerimeve të marra, si dhe të përgjigjeve të dhëna.

7. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

7.1 Të gjithë të dhënat personale do të mbahen në mënyrën e duhur gjatë periudhës së tyre të përpunimit dhe do të shkatërrohen pas periudhës së përcaktuar bazuar në limitin kohor të vendosur në Ligj. MPAY përdor masa të plota sigurie për të ruajtur të dhënat.

7.2 MPAY ka regjistruar emrin e domain-it të saj www.mpay.al në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në përputhje me kuadrin përkatës ligjor në fuqi.

8. PRONËSIA INTELEKTUALE

8.1 Kjo Faqe do të konsiderohet si një tërësi e pandashme. Informacioni që përmban ajo është rreptësisht për përdorim personal. Kopjimi apo transmetimi i tij nuk është i lejuar. Të gjitha të dhënat të përfshira në rubrikat e Faqes janë pronë e MPAY ose partnerëve e saj. Kopjimi, shfaqja apo shpërndarja e të gjitha ose një pjesë të përmbajtjes së kësaj Faqeje, përveç për qëllime personale, është e ndaluar me çdo mënyrë. Çdo moszbatim i këtij rregulli, përbën shkelje dhe mund të sjellë dënime civile dhe/ose penale. Është rreptësisht e ndaluar të përdoret ose kopjohet emri "MPAY", "KUIK" dhe/ose logo e tyre, individualisht ose së bashku, për çfarëdo qëllimi, dhe në veçanti për qëllime reklamimi, pa pëlqimin paraprak me shkrim të MPAY.

8.2 Shkarkimi apo kopjimi i informacioneve nga Faqja e MPAY nuk do të transferojë të drejtën e pronësisë për informacionin e sipërpërmendur. Ju nuk mund të kopjoni, qoftë tërësisht apo pjesërisht, të transmetoni, qoftë elektronikisht apo me mjete të tjera, modifikoni ose përdorni faqen e MPAY për qëllime publike ose tregtare, ose të krijoni lidhje me këtë Faqe, pa pëlqimin paraprak me shkrim të MPAY. Të dhënat e ofruara në Faqen e MPAY janë pronë ekskluzive e pronarëve të tyre përkatës.

9. KUSHTET E PËRDORIMIT TË FAQES

9.1 **Pranimi i Kushteve të Përdorimit.** Nëse ju nuk bini dakord me këto Kushte Përdorimi, ju lutem mos e përdorni këtë Faqe. Nëse e përdorni këtë Faqe, pranohet që ju keni rënë dakord me këto Kushte Përdorimi dhe me këtë Politikë Privatësie. MPAY rezervon të drejtën që të ndryshojë këto Kushte Përdorimi dhe këtë Politikë pa njoftim paraprak përmes përditësimit të tyre në Faqe. Ju duhet ta vizitoni këtë Faqe rregullisht për të rishikuar Kushtet e Përdorimit në fuqi.

Si të na kontaktoni. Kjo Faqe i përket dhe operohet nga MPAY me adresë në Njësia Administrative nr.5, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Tiranë, Shqipëri. Për çdo ankesë, pyetje apo korrespondencë të përgjithshme ju lutem kontaktoni në info@mpay.al.

Markat dhe e drejta e autorit. Kjo Faqe, përmbajtja dhe materialet në të mbrohen nga e drejta e autorit, e drejta mbi markat, sekretet tregtare apo të drejta të tjera të pronësisë industriale apo intelektuale.

Përdorimi nga ana juaj i materialeve të përmbajtura në këtë Faqe. Përdorimi juaj i kësaj Faqeje i nënshtrohet këtyre Kushteve të Përdorimit dhe kësaj Politike Privatësie. Modifikimi apo përdorimi i materialeve të kësaj Faqeje për qëllime që nuk lejohen nga këto Kushte Përdorimi dhe kjo Politikë Privatësie mund të jetë një shkelje e të drejtave të autorit dhe/ose të pronësisë industriale dhe është i ndaluar. Ju mund të aksesoni dhe shfaqni materiale të kësaj Faqeje vetëm për qëllime jotregtare apo personale. Materialet e kësaj Faqeje nuk mund të kopjohen, riprodhohen, ripublikohen, ngarkohen, postohen, transmetohen, shpërndahen apo të përdoren në çfarëdo mënyre tjetër përveç se nëse kjo autorizohet specifikisht prej nesh. Përdorimi i materialeve në website, aplikacione, shërbime apo media të tjera përveç Faqes është i ndaluar.

Ligji i zbatueshëm. Këto Kushte Përdorimi do të qeverisen nga dhe do të interpretohen dhe zbatohen sipas ligjit shqiptar.

Tërësia e Kushteve të Përdorimit. Nëse ndonjë prej parashikimeve të këtushme do të rezultojë i pazbatueshëm, nul apo në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, atëherë ai parashikim do të konsiderohet i ndarë nga këto kushte dhe nuk do të ndikojë në vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e parashikimeve të mbetura.

9.2 MPAY rezervon të drejtën e ushtrimit të të drejtave të pronësisë mbi informacionin e publikuar në Faqe. Këtu ofrohen informacione lidhur me shërbimet e ofruara nga MPAY. Për këtë arsye, MPAY autorizon vizitorët e Faqes të përdorin këtë informacion sipas nevojave të tyre, duke mbajtur parasysh dhe duke përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Informacioni dhe të dhënat e publikuara në Faqen e MPAY konsiderohen të sakta dhe të besueshme, por MPAY rezervon gjithmonë të drejtën t'i ndryshojë dhe përditësojë këto informacione dhe të dhëna. Në këto raste, vizitori duhet t'u referohet gjithmonë informacioneve dhe të dhënave më të fundit;
- MPAY nuk përgjigjet dhe nuk është përgjegjës për asnjë dëm të kujtdo lloji të cilat mund të rezultojnë nga përdorimi i informacionit të publikuar në Faqe;
- Informacionet e publikuara në Faqen e MPAY (duke përfshirë logot, imazhet, njoftimet për shtyp, newsletters, dokumentet, etj.) janë pronë e MPAY.

Kjo Politikë u hartua me qëllim për të qenë e qartë dhe e shkurtër. Në të nuk jepen detaje të plota të të gjitha aspekteve të përpunimit të të dhënave personale. Megjithatë, ne jemi të gatshëm t'ju japim çdo informacion shtesë apo shpjegim të nevojshëm. Çdo kërkesë duhet të dërgohet në adresën e – mailit: info@mpay.al

Kjo Politikë hyn në fuqi me publikimin e saj në Faqen e MPAY.